

30.07.2020

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"EKONOMIA NDIHMËSE E KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR" SHPK

Në mbështetje të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar, si dhe Aktit të Themelimit të shoqërisë "EKONOMIA NDIHMËSE E KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR", shkurt **EN-KKSH** veprimtaria e shoqërisë do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti.

Neni 1

Forma dhe baza ligjore

Shoqëria ka formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose SHPK dhe do të zhvilloj veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodi Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë

Neni 2

Ortakët e shoqërisë

Ortakët e shoqërisë janë:

- Shoqata humanitare "Kryqi i Kuq Shqiptar", Person Juridik, me nipt J62103001Ë dhe adresë kryesore: Rruga "Muhamet Gjollështa", Tiranë, përfaqësuar nga Presidenti I Kryqit të Kuq Shqiptar Z.Ylli ALUSHI, i biri i Tosunit dhe i Elimasë, lindur në Tiranë më 29.08.1956, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, banues në adresën: Sheshi Josef San Martin", Godina 2, Apartamenti 30, Tiranë, me ID F60829089J.
- Z.Gjergj LEGISI, i biri i Ndreut dhe i Vojsavës, lindur në Tiranë më 03.10.1986, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, banues në adresën: Rruga "Nreko Rino", Pallati "Parkside", apartamenti 146, Tiranë, me ID I61003040N.

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



Neni 4

Selia e shoqërisë

Selia e shoqërisë do të jetë: Rruga "Pjetër Budi", Nr.19, Hyrja 10, Tiranë.

Shoqëria mund të hapë degë dhe /ose zyra përfaqësimi, qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera tregtare dhe /ose të huaja. Këto mund të krijohen dhe të mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Objekti i veprimtarisë do të jetë ushtrimi i veprimtarive prodhuese bujqësore dhe veçanërisht kryerja e aktiviteteve të mëposhtme:

- bujqësia e përgjithshme, përfshirë vreshtarinë;
b) pemëtaria (përfshirë olivokulturën) dhe hortikultura (perimet, lulet dhe bimët zbukuruese), edhe në serra;
- prodhimi i kërpudhave dhe i erëzave, i farërave dhe filizave;
ç) mbarështimi i shtretërve të fidanishteve.
- Blegtoria, në lidhje me kulturën e tokës
a) mbarështimi i kafshëve;
b) i shpendëve;
c) i lepujve;
ç) i bletëve;
d) i krimbit të mëndafshit;
- Shoqëria do administrojë dhe zhvillojë asetet bujqësore dhe blegtorale në pronësi të Kryqit të Kuq Shqiptar, të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me Vendimin e Asamblesë së ortakëve.

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë

1 Kapitali themeltar i shoqërisë

- Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është caktuar në masën 10.000.000 (dhjetë milion) lekë dhe është tërësisht kapital financiar i depozituar nga Shoqata humanitare "Kryqi i Kuq Shqiptar". Derdhja në llogari të kompanisë do të bëhet me tre këste përkatësisht; 3.000.000 (tre milion), dhe dy këstet e tjera nga 3.500.000 (tre milion e gjysëm).



- Disbursimi i kësteve do bëhet sipas nevojave që do ketë kompania për likuiditete për të përballuar shpenzimet si ato operative dhe për investime.
- Kapitali themeltar ndahet në 2 (dy) kuota:
 - a) Ortaku, Shoqata humanitare "Kryqi i Kuq Shqiptar", me përfaqësues Z.Ylli ALUSHI, i cili zotëron 50 % të kapitalit themeltar ose 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 5.000.000 (pesë milion) lekë
 - b) Ortaku, Z.Gjergj LEGISI, i cili zotëron 50% të kapitalit themeltar ose 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 5.000.000 (pesë milion) lekë.
- Ortaku, Z.Gjergj Legisi nuk ka të drejtë të shes dhe tjetërsoj aksionet e tij për një periudhë 3 vjeçare nga data e themelimit të shoqërisë si dhe deri në realizimin e fitimeve neto deri në vlerën e dyfishit të kapitalit fillestar.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë realizohet me vendim të Asamblesë së ortakëve.

Ortakët, me kërkesë të administratorit në mënyrë unanime dhe në përpjestim të drejtë të kuotave që posedojnë mund të përmbushin nevojat financiare të shoqërisë nëpërmjet rritjes së kapitalit, duke ruajtur normat e transparencës bankare dhe kërkesat e tjera me karakter fiskal. Rimbursimi i derdhjeve dhe financimeve të ortakëve mund të bëhen me vendim të Asamblesë së ortakëve.

Neni 8

Transferimi i pjesëve të kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:



- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Neni 9

Organi vendimarrës

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:



- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 10

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 11

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.



Neni 12

Administrimi

Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar dhe të drejtën eskuzive të propozimit Për emërim dhe shkarkim të administratorit e ka Shoqata humanitare "Kryqi i Kuq Shqiptar". Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

Mandati është i rinovueshëm.

Administratore e shoqërisë do të jetë Znj.Enida HOXHA, e bija e Altinit dhe Mirelës, e lindur në Tiranë më 04.05.1996 , madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, banues në adresën: Rruga " Eshref Frashëri", Kompleksi TID, Shkala D, Apartamenti 15, Tiranë, me ID J65504069N.

Neni 13

Kompetencat e administratorëve

1. Administratorët kane të drejtë të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4.Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.ne raste kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

- kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.



- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 14

Përgjegjësitë e administratorëve

Administratori është përgjegjës ndividualisht, ndaj shoqërisë dhe të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratorët detyrohen:

1.a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;


ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.



4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) japin kredi.

5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

Neni 15

Viti financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 janar dhe mbaron në 31 dhjetor. Përrjashtimisht, viti financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbaron në 31 dhjetor.

Neni 16

Ekspertët

Experti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë.


Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut të vetëm për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 17

Prishja dhe likuidimi

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të prishet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;



ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

Në këtë rast Asambleja e ortakëve të shoqërisë merr vendim me shkrim me të cilin parashikon mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likujdatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej saj emrin e likujdatorit dhe emërtesën "Shoqëri në likujdim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likujdimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Asambleja e ortakëve të shoqërisë.

Nese Asambleja e ortakëve të shoqërisë nuk merr një vendim për emërimin e likujduesve brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likujdues.

Neni 18

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi – ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 19

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT THEMELUES

Për Shoqatën humanitare "Kryqi i Kuq Shqiptar"

Gjergj LEGISI

Ylli ALUSHI

President i Kryqit të Kuq Shqiptar

